

ANTONETA PRIFTAJ

**KËPUCËT**

ROMAN

---

BOTIMET TOENA



ANTONETA PRIFTAJ

KËPUCËT

*(Historia e një familjeje rome)*

*roman*

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2022

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Anrila Spahija

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-348-69-2

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

[www.toena.al](http://www.toena.al)

Për ata fëmijë e të rinj romë dhe të tjerë fëmijë të braktisur, me të cilët për disa vite, pas rënies së diktaturës, pata kënaqësinë të punoja si edukatore në “Qendrën Sociale Murialdo”, Fier. Bashkë mësuam të shkruajmë, të flasim, të argëtohem, të luajmë teatër, të zhvillojmë biseda sociale, të shkëmbejmë dhe të vlerësojmë traditat dhe kulturën tonë, të ruajmë mjedisin... Mësuam të respektojmë veçantitë tona, duke i parë si pasuri për secilin.

Unë u jam mirënjohëse, se ma bënë jetën ylber të ndritshëm.

Ngjarjet dhe emrat e personazheve në roman janë të trilluara. Janë copëza realitetesh nga jeta e romëve, të treguara nga prindërit dhe nga këta të rinj dhe fëmijë të bukur, dhembshurisht të dashur.

**Autorja**



*Je mësuar të ecësh këmbëzbathur... Dhe kur, më në fund, të vjen mundësia për të veshur këpucë, ti nuk do. Nuk ke më frikë se të vriten këmbët, nuk ke më as ftohtë, as vapë... Por, mendon se ndoshta duhet ta bësh këtë për të shpëtuar plagët e këmbëve nga toka ku ke shkelur gjatë...*

**Maniela Sota**

*(Shkrimtare dhe përkthyesë)*





## Dritani

- Dafinë, dafina, moj gra! Këpusim ca dafina, moooj!

Njëra nga gratë e shtyu Gjylen nga gardhi.

- Shpejt! Ca degë dafine na duhen...! Kemi plot te gardhi!

Oborri i shtëpisë së Gjyles gumëzhinte nga thirrjet e grave që lëviznin nëpër oborr dhe, kush e kush, të ulërinte më shumë... Dikush qante. Ca të tjera përtej portës së oborrit, bënë sehir duke murmuritur fjalë pa kuptim. Fëmijët kishin futur fytyrat e tyre kureshtare përmes kallamave e telave të gardhit, të shihnin se çfarë kishte ndodhur.

Burrat filluan të lidhnin degët dhe gjethet e dafinave që sollën gratë për barelën. Gjylja shkulte flokët e lemerisur, duke ia ngulur sytë pellgut të gjakut. Nuk e shihte dot nipin e vet, që gulçonte nga dhimbjet.

-Tundu, moj, dafina kemi plot! Ç'më rri ashtu si hu gardhi...!

Gjylja ishte mpirë e tëra. Njëra nga gratë i dha një të shtyrë asaj për nga gardhi me dafina.

- Ngrihu, moj! Dafina! Dafinë, moj...! Hajde! Këput ca dafina!

Gjylja u shuk në shesh. Zuri veshët me duar dhe filloi të dridhej.

- Dafinë, dafinë, mooj...! Zëri i grave, që dukej sikur i vinte nga honi i një pusi, po i shkallmonte kafkën. E mbuluan djersë të ftohta. Filloi të fliste përçart...

- Po mbytem...! Pusi...!

Tundej para e mbrapa me veshët të shtrënguar fort me të dyja duart.

- Dafinë, dafinë, moj...! Këpusni ca të tjera...!

Njëra prej tyre, mori një sapllak me ujë dhe ia hodhi në fytyrë. Gjylja ngriti kokën dhe e pa sikur donte t'i thoshte “Ç’ke me mua? Unë jam Gjylja!”

- Korba ti! Ç’të gjeti! Nipi, dhëndër!

Ato i flisnin dhe nduknin faqet, të lebetitura.

- S’ka faj e shkreta! Djali iu zhduk pa nam e pa nishan. Ja, tani edhe nipi....! Ia vranë nipin!

Gjylja shihte me sy të shuar fundin e një pusi të thellë dhe përpiquej të dëgjonte jehonën e tij. “Dafinëëë!”

- Ku është Dafina? Ajo shihte gratë me sy të zbardhur nga tmerri.

- Te gardhi, moj, te gardhi...!

Gratë lëviznin nëpër oborr, vraponin, përplaseshin me njëra-tjetrën... Gjylja, herë shihte gardhin, herë shihte nipin dhe burrat, që po lidhnin barelën me litar. Nuk po kuptonte asgjë nga ajo që po ndodhte.

Një aromë dehëse dafine u përhap ngado në ajër. Mjedisi dukej gati mistik. Kudo ndihej prania e vdekjes. Dy duar të fuqishme e ngritën peshë të plagosurin dhe e vendosën në barelën e improvizuar me degë e gjethe dafine. Dritani rënkonte nga dhimbjet. Në ajër rrinte pezull frika, dhimbja. “Ja vranë djalin...!”

Të plagosurin e mbuluan me batanije dhe e lidhën me litar nga të dyja anët. Vjollca e puthi të birin në ballë. Balli i digjej.

- Bir, kush ta bëri këtë të keqe...! - fliste ajo duke i afruar një tufë me lule të çelura dafine në hundë.

Gjashtë burra u vunë në rresht dhe e ngritën, të tjerë i ndoqën pas. Karvani i burrave kaloi portën. Vjollca u nis me ta duke mbajtur dorën e të birit. Gratë u pozicionuan nga të dyja anët e hekurudhës.

Gjylja nuk u ngrit t’i përcillte. Ajo i shihte e shpërfytyruar. Trupi i dridhej. Duart i lëvizte pa pushim duke goditur kokën, trupin. Mërmëriste si e çmendur:

- U mbyt Dafina! Iku Jetoni! Iku Dritani! Po Gjylja...?

“E përpiu pusi... E përpiu pusi...”, i përgjigjej një zë, që e godiste fort në kraharor.

Karvani u nis në heshtje! Duhej të ecnin gati gjysmë ore, për të dalë në rrugën e makinave, ku do t’i priste autoambulanca.

Komuniteti i romëve jetonte në një lagje periferike të qytetit. Kasollet i kishin ngritur nga të dyja anët e hekurudhës, e cila kalonte fare pranë lumit që përshkonte këtë qytet. E vetmja rrugë që i nxirrte në xhade, ishte rruga e trenit. Burrat, të heshtur, hipnin e zbrisnin nëpër binarë, duke u përpjekur të mbanin një ritëm të caktuar. Ishte karvani më i çuditshëm në botë. Gjashtë burra dhe një grua ecnin si të dehur, duke u tundur poshtë e lart. Barela dukej si varkë, që e kishte rrëmbyer një rrjedhë e furishme uji nëpër shkëmbinj.

Dritani, hera-herës, gulçonte.

- Bir! - gjëmonte Vjollca me zë të shuar. Burrat nxinin. Mustaqet, pis të zeza, u ishin rrëzuar përdhe. Dita po ngrysej. Hijet e zeza të kallamave, që rrethonin si një gardh të dyja anët e hekurudhës, formonin figura të frikshme fantazmash. Fëshfërima e tyre të ngjethte mishin. Vjollca vuri veshin. “Çfarë thonë?!” I gjëmonin veshët. Ndiante therjen e mishit nga zërat brisk të kallamave. Dielli, çuditërisht, gjak i kuq. Diku ndihej ndonjë cicërimë zogish. Loja djallëzore e hijeve, e ngjyrave dhe e zhurmave, errësira e natës, që po zbriste tinëzisht, dhe hapat e dehur të dhimbjes, që kishin kapluar karvanin, bashkoheshin me rënkimet e të plagosurit. Vjollca ecte e pengoj. Ajo përpiqej të shihte

fytyrën e të birit nga ndonjë rreze dielli në ikje. “Allah! Mos ma merr tim bir!” Në heshtje, përtypte lotët, që i rridhnin rrëmujshtëm.

- Përse? - theu heshtjen njëri nga burrat. Ishte Avniu, më shtatlarti i karvanit.

- Allahu e di! - u përgjigj një zë i mbytur. - Ne kaluam ato ngjarje të tmerrshme të '97-s, kur plumbat na fishkëllenin ngado dhe nuk na gjeti gjë. Kush ia preu këmbën djalit tonë? Dhe ku, në lagje, në shtëpi...

Komuniteti rom e kishte kaluar atë vit të keq të kaosit që u krijua nga shpërbërja e shtetit, pas rënies së firmave piramidale, të asaj çmendurie njerëzore të vitit 1997... Ata, banorët e hekurudhës, nuk u përfshinë në të. Asnjë rom nuk mori armë, kur njerëzit e qytetit kishin shpërthyer depot. Të gjithë luftonin kundër të gjithëve. Në rrugë shiheshin fëmijë me armë në duar...

Ditën dhe, sidomos, natën, krismat nuk kishin të pushuar. Romët, të organizuar, bënë rojë me radhë e nuk lejonin asnjë të huaj të afrohej në lagjen e tyre. Ndërsa qyteti, gati i paralizuar, dukej se i kishte harruar përfundimisht ata, romët, që jetonin atje, te shinat e trenit në periferi të tij.

- Allahu e di! - u dëgjua një zë i dridhur. Ishte Selimi. Avniu, që kishte folur pak më parë, kafshoi gjuhën në heshtje.

Selimit, në vitin 1999, kur mendohej se kishte kaluar më e keqja, iu vra djali i vogël gjashtë vjeç nga një granatë, të cilën e kishte gjetur në kazanin e plehrave, në lagjen që kishin pranë. U vra duke luajtur me të. E varrosi djalin pranë gardhit të tij, që kufizohej nga lumi. U përpoqën ta ndalonin, sepse zakoni e donte ta varrosnin larg, pa shenjë, por ai s'pranoi.

“I vdekuri të mban lidhur pas vetes, në qoftë se do të ketë një varr. Shpirti i romëve kërkon të jetë i lirë!”

“Është i vogël! Nuk e lë vetëm në vende të panjohura! Edhe unë, kur të vdes, këtu dua të më vini, bashkë me djalin!” Kështu u ishte përgjigjur ai atyre dhe e varrosi të birin pranë kasolles së tij. Ia mbushi varrin me lule dhe çdo mëngjes e përshëndeste me fjalë të ëmbla.

U dëgjua një psherëtimë e thellë. Selimi fshiu mustaqet e rënduara nga lotët. Karvani heshtte. Dëgjoheshin traketruket e hapave të rëndë, që ngjethnin të zezën e natës, e cila po i mbështillte me ftohtësinë e saj.

Një dridhje e lehtë u ndje në shina. Nga larg u dëgjua sirena e trenit. Karvani u shkërmoq në të dyja anët e hekurudhës. Barela u anua. Burrat u kujdesën që të mos lëndohej i plagosuri. Treni u afrua si një përbindësh i madh, i zi. Një ankth i kaploi të gjithë. Sonte klithma e tij dukej më e madhe, gati e panjohur për ta.

Ishin mësuar ta dëgjonin dy herë në ditë këtë tren tek trondiste kasollet dhe zemrat e tyre. Por sonte oshtiu ndryshe. Sonte, treni-përbindësh, i madh e i frikshëm, imitonte me arrogancë traketruket e këmbëve të stërmëdha të karvanit. Romët nuk e konceptonin dot jetën pa trenin dhe pa lumin, në breg të së cilit kishin ndërtuar lagjen e tyre. Prania e tyre dukej sikur përpiqej t’u kujtonte, se ata duhej të ecnin, të lëviznin. Por, ndryshe nga shumë romë të tjerë, që shtegtonin në vende të ndryshme, ky komunitet u ngul aty, në të dyja anët e hekurudhës. Më parë, ngulimi i tyre ishte fare pranë qendrës së qytetit, në buzë të lumit. Sipas një urdhri të kryeministrit të kohës, në diktaturë, romët e kishin të ndaluar të jetonin pranë qendrës së qytetit. Protestuan atëherë, por askush nuk ua vuri veshin. I shpërngulën dhe i vendosën në periferi. Nga perëndimi kufizoheshin nga varrezat e vjetra të qytetit; nga lindja, nga një lagje e vogël dhe nga jugu nga lumi.

Komuniteti dukej se nuk do të shtegtonte më sipas zakonit. Me lumin dukeshin si të zënë në kurth. Dikur ky lumë ishte i pastër. Me ndërtimin e dy uzinave të mëdha, u shndërrua në një lumë të çuditshëm. Ai lëvizte si një gjarpër i madh i zi dhe shfrynte arsenik gjithë kohën. Qyteti dhe romët, që jetonin buzë tij, gdhiheshin e ngryseshin me mushkëri të rënduara. Qytetit, dukej se i kishte ikur kujtesa. Dikur ky lumë ishte bukuria e tij. Gratë lanin rrobat, fëmijët notonin, luanin... Legjendat për të thoshin se lumi, pëshpërit me mijëra fjalë dashurie, që i dëgjonte nga çiftet e dashuruara tek vidheshin netëve brigjeve të tij. Në të dyja anët e tij kishte lule shumëgjyreshe. Tani, lumi i trishtuar rridhte ngadalë dhe pa gjallëri. Mushkëritë e tij frymonin naftë e bitum. Njerëzit kujtoheshin për të, kur lumi fryhej nga shirat si një përbindësh i madh, dhe nxirrte inatin duke përmbytur fusha e shtëpi, bagëti e të mbjella dhe duke hedhur mbi gjithçka pelerinën e tij të zezë me naftë. E kur ai, i lodhur, kthehej në shtratin e tij, njerëzit harronin përsëri. Romët jetonin me hallet dhe varfërinë e skajshme, me ahengjet dhe dashuritë e tyre.

Kjo ishte lagjja e romëve, që mbështillte një pjesë të hekurudhës, që gremisej në lumin e helmuar.

Kur treni u zhduk në errësi, karvani u nis përsëri për udhë.

Trakatruk-trakatruk! Trakatruk-trakatruk!

Në ato momente u dëgjua një zë, gati si pëshpërimë:

- Lale, qengji! Qengji është te shinat! Treni ka shtypur qengjin!

Vjollca iu afrua të birit. I vuri dorën në ballë. Balli akull! Balli i djersitur dhe akull i ftohtë.

- Çfarë the? - Vjollca u përkul mbi fytyrën e të birit.

Karvani ndaloi një moment duke u përpjekur të ruante ekuilibrin. Dritani belbëzonte.

“Lale”, kështu e thërriste të ëmën me përkëdheli. Kjo ishte fjala e parë që ia kishte mësuar gjyshja. Vjollca do të kishte dashur që ai ta thërriste, nanë, si e thërriste ajo të ëmën. Gjylja nuk kishte pranuar. Edhe vetë ajo, nuk e dinte ç’do të thoshte për të, kjo fjalë.

- Lale, treni ma shtypi qengjin. I doli shumë gjak.

Vjollca u drodh. Iu kujtua i biri kur ishte gjashtë vjeç.

*Kishin një qengj që do ta therrnin për festën e Shën Gjergjit. Kur djali po e kulloste, qengji kaloi në shina dhe e shtypi treni. Vjollca e tmerruar e pa skenën dhe vrapoi tek i biri. Kur treni u largua, para syve i doli djali me duar të gjakosura, që mblidhte zorrët e qengjit. Gjylja, gjyshja e tij, ia kishte ulur kokën mbi qengjin e vrarë duke i bërtitur.*

- Ku i pate sytë! Na e hoqe nga goja!

*Nga era e gjakut të ngrohtë dhe nga tronditja, Dritani kishte vjellë mbi të.*

- Ç’bën kështu, moj e pashpirt!

*Vjollca i kishte folur së vjehrrës dhe ia kishte rrëmbyer të birin nga duart. Që atëherë, Dritani nuk shikonte dot gjak dhe mishin e qengjit nuk e fuste në gojë...*

- Treni! - u dëgjua përsëri mërmërima e Dritanit.

- Iku treni. Iku. Mos ki frikë! - foli Vjollca mes dënesash.

“Qengji i mamit!”, e përkëdheli të birin duke folur pa zë.

Burrat dëgjonin në heshtje. Tanimë nxinin më shumë vetullat dhe mustaqet e rrëzuara, si çadrat e plazhit pas një rrebeshi.

- Në fillim i ati... U zhduk si kripa në ujë, pa nam e nishan... Tani, ja, i vranë të birin, - foli Aliu, më i riu karvanit.

- Asnjë haber nga i ati. E la djalin të parritur. Kanë ardhur kohëra të vështira... - e plotësoi Avniu.

Vjollca psherëtiu. Kishte vite që e kërkonte të shoqin kudo. S'kishte lënë njeri pa pyetur për të.

- Eh, kohëra të vështira, - vazhdoi Selimi, për të përforcuar thënien e Avniut.

- Sa janë zhdukur...! Sapo ra diktatura, njerëzit mësynë kufijtë për të dalë nëpër botë. U mbytën deteve, me gomone apo me fuçi. Sa të tjerë ngrinë maleve me dëborë. Sa u vranë nga grabitësit...!

- Me kokë në torbë edhe ne... - foli Kadriu, që nuk ishte ndier gjer atëherë.

- Ama, ne, ishim të parët, që kapërcyem kufijtë. Ra diktatura. Morëm krahë, vëlla. E kemi shpirtin të lirë, ne! Ne nuk i njohim kufijtë... - shpërtheu ai sikur donte të nxirrte një duf të mbajtur brenda prej kohësh.

Vjollca, psherëtiu. "Pesë vite. Asnjë lajm nga Jetoni! Zot, mos është ngatërruar ai me ndonjë andej nga ka shkuar dhe tani po hakmerren ndaj djalit?" Ky mendim e tronditi. "Qyqja unë...!"

- Oh, jo, Jetoni nuk ngatërrohej me asnjë! Ai nuk i ka bërë kurrë keq asnjë njeriu, - mendoi me zë të lartë Vjollca.

U dëgjua një psherëtimë.

- Kjo e sotmja është shumë e rëndë. Ku ishim ne që e lamë pa mbrojtje këtë familje me dy gra dhe një djalë të parritur? - shpërtheu Nazifi.

- Nuk i mbrojtëm... - u dëgjua Qaniu, më i moshuari i grupit.

- O, burra! Më dëgjoni mua. Unë jam i sigurt se Dritani do të shërohet. Ne jemi të fortë. Do ta kapërcejmë edhe këtë, - foli përsëri Nazifi.

Nazifi mbahej më i shtruari dhe më optimisti nga të gjithë në lagjen e tyre. Kënga e violinës së tij ishte magjepsëse.



Nëpër dasmat, ditëlindjet apo gëzimet familjare, që bëheshin në qytet dhe nëpër gjithë Shqipërinë, Nazifi ishte më i kërkuari. Pas disa gotave me raki, ai ndizte dasmën, bashkë me orkestrën që kishte ngritur me shokët e tij.

U dëgjua një e qeshur e mbytur.

- Ç'pate, o Avni?

- S'di sesi m'u kujtua historia e doktoreshës. Ç'hall që pati ky i dashuruari ynë...

- Aman, na e trego, - u dëgjua një zë nga ata më të rinjtë, që i ishin bashkuar karvanit gjatë rrugës.

- Ky i marrosuri, bashkë me Telon dhe Fadilin, se janë bërë për ndjesë, mu përpara poliklinikës së qytetit, i bënë koncert doktoreshës, e cila i vuri dhëmbin prej floriri në gojë.

- Doktoreshë, vër maskën, se unë kam qenë i shtruar në sanatorium, - i tha ky, sapo u ul në poltron.

Ajo e pa në sy dhe e falënderoi me mirënjohje. Ky yni ra në dashuri menjëherë me të. Doktoresha ishte një vajzë e bukur, me një gërshet që i rrinte te beli. Atë ditë kur bënë koncertin, në të gjitha dritaret e poliklinikës, kishin dalë mjekë e infermierë të dëgjonin këngën e tij. Vetëm ajo, doktoresha, nuk doli.

- Ha-ha-ha! - u dëgjua e qeshura e Avniut.

Nazifi qeshi nën mustaqe. Dhëmbi i florinjte shkrepiti në errësirën e buzëmbremjes.

- Po, çfarë bëni, more! Ne kemi hall, ju qeshni, - foli rëndë Qaniu.

Të gjithë heshtën. Traka-truk, traka-truk! Trakatruku ndihej më i rëndë. Vjollca vazhdonte të qante në heshtje. I hidhte hapat si e dehur në errësirën e natës dhe pengohej në gropat e hekurudhës.

- Kur u vra djali i Selimit, ne nuk lamë këmbë njeriu të futej në lagjen tonë. Atëherë tregtinë e rrobave e të plaçkave e shpërngulëm në qendër të qytetit. Fëmijët i porositëm të mos rrinë në kryqëzime rrugësh dhe të gjithë të dilnin në grupe me më shumë se tre a katër shokë. Dhe, shyqyr Zotit, nuk na ndodhi gjë.

- E po, harrojmë shpejt ne, njerëzit... - u dëgjua një zë tjetër.

Bilali ishte më i heshturi. Ishte ndër të paktit në lagje, që punonte në shtet. Ishte shtatlartë, muskuloz, me sy të ndritshëm, të zinj. Mbahej si me qejfliu në lagje.

Dy apo tri herë goditi kokën me gusht.

- Uf! Uf!

- Po ti, ç'pate? - i foli rëndë Qaniu.

- Hiç, o hiç! - ia ktheu Bilali.

- Uf! - u ndje përsëri zëri i tij, këtë radhë si një zë i mekur, sikur donte të çlirohej nga një brengë e fshehur, që nuk e ndante dot me të tjerët. Papritur barela u anua, të gjithë reaguan menjëherë.

- Ç'bën kështu, more! - folën ata me një gojë. Bilali kafshoi buzën dhe heshti.

*Ishte mbrëmje vonë. Vjollca me djalin sapo ishin shtrirë për të fjetur. Gjylen s'po e zinte gjumi. Vërtitej në shtresa me brengën, që i biri, Jetoni, nuk i kishte dërguar asnjë lajm. Bilali, fqinji i tyre, gjysmë i dehur, hyri në oborr dhe trokiti në derën e kasolles së Vjollcës. E pëlqente Vjollcën. Sa herë e shikonte i rrihte zemra. Në atë moment, qeni i lidhur lehu me të madhe. Gjylja e ndjeu e para dhe iu turr me një dru që e mbante te dera e kasolles së saj. Bilali duke u tundur iku me vrap dhe dëgjoi se si Gjylja i ulërinte nuses së djalit.*

*- Ti, moooooj...! Për ty, për ty, vijnë ata! S'e kam djalin këtu, po ta tregoja unë qejfin ty...!*

*Vjollca, e trembur, iu zmbraps së vjehrrës, që kishte ngritur drurin mbi kokën e saj. Nipi ia rrëmbeu drurin nga dora, i doli gjyshes së tij përpara dhe i bërtiti:*

*- Provo ta prekësh mamin me dorë! Ti, ti je shkaktare, që iku babai! Harrove? Ti! Lëre mamin rehat!*

*Dritani nuk e kuptonte gjithë atë mllef që kishte gjyshja ndaj mamasë së tij.*

*- Pse sillet kështu me ty? - shfryu ai duke ndjekur me sy gjyshen dhe i hodhi dorën në qafë së ëmës. Vjollca u habit me të birin. Në atë moment u ndje më e sigurt se kurrë.*

Trang-trung, drang-drung...

Karvani gjëmonte nga brenga. Tundej, tani më rëndë, drang-drung, si një ecje të verbërish, në gropat midis binarëve.

- Lale, më dhemb...

- Ja, arritëm, edhe pak.

Zëri i Vjollcës dilte i shurdhët. Çalonte karvani, çalonin edhe mendimet e burrave fytyrëngrysur.

- S'ka shtet ky vend, - u dëgjua Sokrati.

- U bënë gati gjashtë vjet nga ai viti i keq i '97-ës, e ndodhin akoma vrasje.

Sokrati fliste duke marrë frymë me vështirësi. Ai e kapi kolonën me vrap, se ishte kthyer vonë nga puna.

- Çfarë shteti! - shpërtheu Qaniu.

Një moment burrat shtangën. Nuk e kishin dëgjuar kurrë Qaniu të ngrinte zërin.

- Ne kemi veten tonë. Kur na ka ndihmuar shteti? As atëherë, as tani. Demokraci... Llafe... Unë s'të ngacmoj, ç'ke që më bie në qafë ti? Pse ma vret djalin?

- Një polic duhej edhe këtej nga lagjja jonë... - foli Sokrati me atë zërin e ulët dhe të ndrojtur. - Jetojmë me hallet tona,

me varfërinë tonë, por jemi njëqind herë më të mirë se ata andej, - dhe ktheu kokën nga lagjia e qytetit përbri.

- S'ke punë me ata, ti! Nuk ta kanë fajin ata. Edhe ata kanë halle si ne... - foli përsëri Qaniu kërcënueshëm, me zë të ulët.

Komuniteti rom përpiquej të ruante marrëdhënie të mira me banorët jo rom të lagjes pranë. Ata shpesh mbushnin ujë për të pirë në çezmën e përbashkët të asaj lagjeje.

Sokrati qeshi nën hundë.

- Gaxhorrat, thuaj. E di ç'më ka ndodhur njëherë? Një nënë nga lagjia përbri po e kërcënonte fëmijën e saj që po qante: "Pusho, se i thashë këtij gaxhorrit, të vijë...", dhe pa nga unë. Atëherë unë iu afrova.

- Ka të drejtë mamaja, pusho se të vjen gaxhorri! Dhe, gjithë rrugën kam qeshur me vete. Ne romët, njerëzit e bardhë i quajmë në gjuhën tonë gaxhi, gaxhie... Gruaja nuk e dinte, se ai që trembte fëmijën ishte një gaxhi apo gaxhorr, nga i llojit të vet. Hahaha, edhe ne i trembim fëmijët: erdhi gaxhia...!

Sokrati heshti, kur vuri re se askush nuk qeshi me të.

- Dashka polic, ky shoku... - vazhdoi bisedën Avniu.

- Çfarë polici thua ti, more njeri! S'kemi parë kurrë polic këtej nga ana jonë, - vazhdoi Qaniu bisedën e ndërprerë të Avniut.

Vjollca, pa dashur, vuri buzën në gaz. Para syve i doli një polic që kishte ardhur në shtëpinë e tyre për të blerë plaçka në fillim të viteve '90...

*Ishin vitet kur ra diktatura. Shqipëria jetonte krizën më të madhe të varfërisë. Romët ishin të parët që kapërcyen kufijtë, nga malet e nga deti, në shi edhe në dëborë. Sollën dengje me rroba të përdorura dhe stoqe, plaçka të llojeve nga më të ndryshmet, dyshekë, këpucë, veshje gjithfarëlloj, deri edhe panolino për fëmijë, që atëherë ishin të panjohura*

nga nënat shqiptare. Gjylja ishte ulur mbi një dëng me rroba në mes të oborrit dhe thërriste me të madhe:

- Hajde rroba të lira e të mira! - thërriste dhe shihte me dyshim policin që, i hutuar, po rrinte te porta.

- Hajdeni, motra, kemi rroba firmato! Firma "Amani". Dermani, moj gra...! - thërriste Gjylja dhe, duke e ditur që nuk i thoshte mirë këto emra, qeshte nën buzë...

Polici iu afrua si me ndrojtje dengut me rroba të trikotuara, mbathje, kanotiera, benevrekë... e filloi të kontrollonte. Vjollca që qeshte me Gjylen, ndërsa ajo përmendte rrobat firmato, ishte në këmbë e po shihte policin. Ai pa hijen e saj dhe ngriti kokën. "T'ëmën... - mendoj, - sa e bukur qenka arixheshka!"

Gjylja, kur e pa që ai s'po ia ndante sytë nuses së saj, u ngrit vrik në këmbë.

- Çfarë kërkon ti? - iu drejtua policit.

- Kanotiera, - tha ai duke iu marrë goja.

Gjylja mbushi duart me rroba të trikotuara.

- Sa kanotiera do ti? Na, na dhe tri palë brekë për vete dhe tri palë brekë për gruan tënde po t'i fal, - dhe ia ngjeshi me forcë në duar. Polici i mblodhi shuk dhe i vuri nën sjetull. Kur arriti te porta, ktheu edhe një herë kokën pas e pa gratë që po qeshnin me shpoti. Gjylja iu drejtua nuses së saj:

- Futu brenda ti dhe mos u zgërdhi me burrat e botës!

Vjollca u përmend. "O, Zot! Ç'mendoj dhe unë tani! Allah! Më ndihmo djalin!" Shtrëngoi dorën e ftohtë e të djersitur të të birit. Ishte gjysmerrësirë dhe nuk po e shquante dot fytyrën e tij, por me sytë e nënës po e shihte atë fytyrë që digjej në ethe. "Allah! Mbroma djalin! E kam dritën e syve!" Iu përgjërua qiellit në heshtje.

*Atë pasdite, sapo ishte kthyer nga puna e kishte gjetur të birin në një pellg gjaku duke shtrënguar fort këmbën e majtë. Ai rënkonte. Nga goja i dilnin jargë. Sytë i kishte të kuq dhe fytyra i kishte marrë ngjyrë jeshile. “Korba unë...!”, thërriste ajo. Ndiente si Dritani belbëzonte me një zë që i dilte nga kraharori, gati i shuar. E çara në këmbën e tij dukej si një gojë e madhe e zezë që gulçonte gjak. Vjollca ia kishte shtrënguar fort plagën me një dorë dhe me dorën tjetër përpiquej të largonte mizat që ishin mbledhur rreth saj. Sa miza kishte atë ditë...!*

*Gjylja kishte ardhur mes ulërimave*

*- Fol, kush ma vrau djalin! Ti, ti i ke fajet! - Dhe, shikonte e lemerisur nga Vjollca. Vjollca qante me ngashërim.*

*Gjylja, me sy të çmeritur, tundte gishtin drejtuar nga ajo.*

*- Ti! Ti! Ti m' i ke fajet!*

*Në moment, oborri ishte mbushur me njerëz. Gjithë lagjja ishte mbledhur aty.*

*- Fati, fati i jetimit! - Gjylja kishte ngrirë me gishtin nga Vjollca.*

*- Ti! Ti!*

*- Mblidhe veten! - Vjollca e kishte shtyrë mënjana të vjehrrën.*

*- Mua po më vdes djali, ti flet përçart!*

*Ajo nuk e kuptonte shkakun, pse e vjehrra e bënte gjithmonë fajtoreshë, për çdo gjë... Thellë, ajo nuk e urrente vjehrrën. Shumë herë edhe e justifikonte.*

*“Kushedi sa ka vuajtur, e shkreta...!”*

*Vjollca, e çoroditur nga tronditja e atij momenti të parë, kur kishte parë të birin që gulçonte në mes të oborrit, përpiquej të ecte me ritmin e karvanit, por nuk po arrinte të*

kontrollonte mendimet, që shtyheshin e përgjakeshin duke goditur fort tëmthat e saj...

Karvani nxinte.

Matanë kallamave u dëgjuan të lehura qensh, që vinin nga ana e vendit ku kishin qenë dikur varrezat e qytetit. Kishte pak vite që ato i kishin zhvendosur dhe i kishin transferuar në vend tjetër. Askush nuk e dinte me saktësi, se ç'punë prishnin varrezat e qytetit në atë vend. Dhe, thoshin, se ato ishin shumë të vjetra. Njerëzit i zhvarrosën të afërmit, por kishte edhe shumë varre të braktisura; nuk dihej për shumë njerëz ku i kishin të afërmit e tyre. Thoshin që kishin parë eshtra, të mbetura aty-këtu, që punëtorët nuk i kishin transferuar në vendin e ri. Kjo e rëndonte më shumë gjendjen, sepse në lagje, filluan të flisnin për fantazma që dilnin natën. Varrezat u zëvendësuan me një varg bunkerësh, që dukeshin si çibanë në atë pjesë toke ku kishin fjetur qindra të vdekur. Askush nuk shkelte në ato toka, nga frika e fantazmave që banonin në këta bunkerë. Kohët e fundit, flitej se këtyre tokave u kishin dalë pronarët e vjetër, të cilët, netëve dilnin të armatosur për t'i ruajtur këto toka.

Vjollca ktheu kokën andej instinktivisht. Të lehurat e qenve, të cilët, përtej kallamave, filluan të shoqëronin karvanin e burrave, duke vrapuar e gulçuar, duke hipur e zbritur nëpër bunkerë, u dëgjuan më fort.

E lehura e qenve e përmendi, Vjollcën. “Ëndrra. Qentë që lehnin...”

U përpoq të kujtonte ç'kishte ndodhur atë mëngjes, duke e lidhur me ëndrrën e një mbrëmjeje më parë.

*Zvarriste këmbët nëpër një baltë të rëndë. Binte shi dhe ajo mudohej me këmbët plumb t'u largohej qenve që e ndiqnin pas.*

*U zgjua e trembur. Vuri dorën në ballë. Ballin, flokët i kishte ujë. Shtriu këmbët, e lodhura, sikur donte të hiqte atë baltë të rëndë të ëndrrës. Zemra i rrihte si e çmendur. Nga llamarinat që mbulonin kasollen, i binte një curril uji drejt e në fytyrë.*

*“O, Zot, ç’ ishte ajo ëndërr ashtu...!” Zgjati kokën nga dera e kasolles. Jashtë binte shi pa pushim, herë me rrebesh dhe herë më lehtë. Vetëtimat thernin errësirën. Çatia me llamarina kërciste sikur binin qindra gurë nga qielli. Vjollca ngriti sytë nga tavani. Një curril shiu, që i binte në fytyrë, e kishte zgjuar. Mbajti vesh. Çatia dukej sikur do të shkatërrohej nga çasti në çast... Shpesh, kur shiu ishte i shtruar dhe i qetë, asaj, i pëlqente kjo muzikë e veçantë shiu në vjeshtë apo në pranverë. Por këtë natë, goditja e llamarinave i binte dhimbshëm mbi kokë. Pjatat, legenët, tavat, që i kishte vënë të mblihdnin ujin që hynte nga të çarat e çatisë, bënë një zhurmë të çuditshme. Fshiu fytyrën me një pecetë. U ngrit. Ndezi qiririn që e mbante poshtë jastëkut. Aso kohe, qyteti ngrysej dhe gdhihej pa energji elektrike. Hapi pak derën e kasolles. Ajo rënkoi thekshëm. Vjollca u tremb se mos zgjonte Dritanin. Iu afrua të birit, e puthi në ballë dhe i mbuloi këmbët e z bathura, që i kishin dalë nga jorgani. Fytyra e tij e bukur kishte marrë hije prej burri. Jorgani i rrinte i vogël. Ishte jorgani i parë me lecka, që e vjehrra e kishte mësuar ta qepte vetë. Qeshi me vete “Sa është rritur im bir! S’ e nxë më jorgani.”*

*Pa jashtë. Po gdhihej. Shiu, në degët e kumbullës, kishte formuar rrathë nga drita e venitur e gjysmëhënës dhe gjysmëdiellit të mëngjesit. Qentë e lagjes nuk ndiheshin, si dukej, dremisnin nën ndonjë strehë të mbrojtur nga shiu. Hodhi një xhaketë të vjetër në kokë, veshi një palë këpucë të vjetra të mëdha që shërbenin për jashtë. WC-ja ishte në*



*oborr. Iu afrua pusit. Hapi kapakun. Çikriku vajtoi. Kova, duke u përplasur mureve të pusit, ra e dorëzuar, me një pllajqurimë të fortë mbi ujë. I hodhi një kovë uji wc-së, e cila, në ditë shiu, kundërmonte më shumë. Lau sytë dhe me duart në fytyrë, u përpoq të kujtonte ëndrrën që e kishte zgjuar. “Zot, ç’ ishte ajo ëndërr!” Ndiente një boshllëk në stomak. “U zgjova nga shiu... apo...?!”*

*U rrëqeth.*

*Ç’ ishte ajo ëndërr...!*

*Ecte duke tërhequr këmbët zvarrë nëpër një baltë të madhe. Mezi çapitej. I dukej sikur dikush e ndiqte pas dhe balta ishte e rëndë, këmbët të rënda. Nuk i kujtohej shumë mirë. Një mjegull e frikshme nuk e lejonte të shikonte përpara.*

*“Shkofshin me natën!”, iu kujtuan fjalët e nënës së vet, kur fliste me gjyshen për ëndrrat. “Zot, më ruaj djalin!” U ul pranë të birit. Krevati i improvizuar me dërrasa, që mbështeteshin në ca tulla, kërciti. Dritani hapi sytë e qeshur.*

*- Vajti ora?*

*Vjollca me të birin punonin mbrëmjeve. Vjollca pastronte rrugët e lagjes që kishin pranë. Ishte një lagje e re, në kodrën e qytetit. Me vila të bukura, të ndërtuara në vitet e demokracisë. Dritani e shoqëronte të ëmën, ndërkohë mblidhte kanoçe, letra, shishe e të tjera mbetje, që i çonin te qendra e grumbullimit. Ai dilte vetëm netëve, ditën kishte turp të kërkonte në koshat e plehrave. Kur binte shi, punëtorët e pastrimit të qytetit nuk punonin. Kështu, Vjollca, e la të birin të flinte atë natë. Gjithçka që fitonin, ishte e pakët, por kështu, e shtynin disi. Lekët që kishin mbledhur dikur nga shitja e rrobave të përdorura kishin mbaruar. Ikja e Jetonit papritur, e rrëzoi fare ekonominë e familjes; kështu, Dritanit i duhej të punonte me të ëmën.*

- Fli! - i tha e ëma, - jashtë bie shi akoma.

Vjollca zbrazti të gjitha enët që kishte vënë për të mbledhur ujën e shiut.

- Fli, ti, fli! - I hodhi sytë përreth. Dhoma ishte e vogël, e varfër, por mbante erë gëlqereje. Pranë derës, një xham, sa pëllëmba e dorës, i ngulur në mur, shërbente si dritare. Rregulloi nimin e saj që i shërbente si krevat. Krehu flokët duke u parë në një pasqyrë të bukur, që e kishte marrë nga plaçkat që kishin shitur. Ishte objekti më i bukur që kishte në kasollen e saj të varfër. U sigurua që i biri nuk ishte lagur, pastaj u shtri në këmbët e tij. Vjollca shquhej në lagje si grua pastërtore. Të birin e mbante dritë. Vinte nga një familje rome, që jetonin në apartamentin e katit të parë të një pallati, nga ato pallate që ishin ndërtuar me punë vullnetare. Edhe ajo, bashkë me të atin dhe me banorët e tjerë, kishte punuar për ndërtimin e tij, vullnetarisht. Në përgjithësi, në katet e para, strehoheshin njerëzit, që nuk kishin njohje apo përkrahje në këshillat popullore të lagjeve. Të pakët ishin ata romë, të cilët ishin strehuar në apartamente. Në përgjithësi, shikoheshin si qytetarë të dorës së dytë. Shumë pak nga ata kishin arsim. Por ata, të bukur, të fortë, dinjitarë, me rregullat, me gjuhën dhe traditat e tyre, mbijetuan. Vjollca, kishte bërë tri klasë fillore. Jetoni e kishte rrëmbyer kur ishte vetëm trembëdhjetë vjeçe e që atëherë, ajo i kishte humbur fare lidhjet me familjen e saj. Jetoni në atë kohë, jetonte me të ëmën në një kasolle të vogël. Me zgjerimin e familjes, Jetoni ndërtoi një strehëz të vogël në një oborr me të ëmën. Shpesh, Gjylja, i binte më qafë, i krijonte probleme nuses, por Vjollca e donte. E ndiente se shpirtin ajo e kishte të mirë. Sytë i kishte të butë e shikimin e kishte të vuajtur. E donte edhe ngaqë i mungonte

nëna e gjyshja e saj. Jetoni e donte shumë gruan e tij, por, ndonjëherë, vinte i dehur dhe grindej me të të. Çuditërisht, Gjylja i dilte në krah nuses...

Vjollca pa nga xhami, jashtë. Gjylja, me sa dukej, flinte akoma. Ndezi furnelën me vajguri, që lëshoi një tym dhe erë të rëndë dhe pastaj e shtroi flakën. Vuri xhezven e kafesë. Po zbardhte. Hodhi sytë lart. Një pikë uji rrinte varur në tavan, duke u dridhur. Ylber ngjyrash vetëtinte currila e ujit. Vjollca ia nguli sytë. Sikur i vinte keq, që ajo do të binte përtokë. Bëri të dyja pëllëmbët kupë, për ta pritur. “E gjora! Ra. Vdiq. Mos ka vdekur, Jetoni?”, ky mendim e bëri t’i dridhej zemra. “Pse e mendoj kaq shumë vdekjen...? O, Zot, bëj që të më vijë gjallë im shoq!”

Dritani ishte zgjuar dhe shihte të ëmën, që lëvizte buzët sikur fliste me vete.

- Ç'bën? Me kë po flet?

Vjollca u përmend.

U ngrit në këmbë. “Uf! Moj nënë! - mendoj. - Ç'ishte ajo ëndërr...!” Ishte e lodhur. Gjymtyrët i dhembnin. “Nga balta e ëndrrës”, e gërreu përsëri mendimi.

Kaffja po fryhej. Vjollca përvëloi dorën me bishtin e xhezves dhe me kafënë që u rrëmbye pak dhe u derdh. Dritani ndjeu erën e kafesë, u shtriq dhe foli përgjumësh.

- Po për mua, ka kafe?

E ëma qeshi. I pëlqente nganjëherë ta pinte kafënë me të birin. Që nga ikja e të shoqit, gjithë dashurinë e kishte hedhur tek ai.

“Allah, ma mbro trimin tim!”

U përmend nga kujtimet. Shpejtoi hapat që të mos mbetej mbrapa karvanit. I shtrëngoi fort dorën të birit që vazhdonte të digej nga ethet.

- Një gjë s'kuptoj unë, - u dëgjua të fliste përsëri Avniu, - e dehën me raki dhe pastaj e goditën. Ky djalë është fëmijë i mirë. Kurrë nuk ka pirë pije alkoolike...

Askush nuk u ndje. Përpara u shfaqën dritat e rrugës kryesore të qytetit. Nga larg shquan autoambulancën. Po i prisnin.

- Shpejt! Shpejt!

Petriti, një djalosh me trup atleti, ishte nisur më parë me vrap, për të lajmëruar autoambulancën në spitalin e qytetit.

- Nuk donte infermieri, më tha se ishte i lodhur, se kishin pasur shumë punë sot, - foli ai dhe u afrua të ndihmonte burrat për të mbajtur barelën.

Në qytet, në ato vite, kishte shumë ngjarje. Shumë të plagosur. Shumë të vrarë. Spitalet ishin plot.

- Po ju, ç'u bëtë? - nisi të fliste me zë të lartë shoferi. - S'kemi qejfin tuaj, ne... E keni mirë ju, i ktheni ca gota raki dhe vini e na kërcënoni, - dhe ktheu kokën nga Petriti. Dukej që ai, kishte bërë fjalë me të.

Burrat u afruan në heshtje. Nxinin. Shoferit i mbeti fjala në gojë. Me zë të ulët murmuriti:

- Kemi pasur shumë punë. Dy autoambulanca kemi në spital gjithsej, - foli nëpër dhëmbë, si për t'u justifikuar dhe hapi derën e autoambulancës. Burrat nuk folën. Në heshtje e futën barelën në makinë.

- Sot një grua lindi në lulishten e qytetit. Vetëm i shoqi dhe një polic, që u gjend aty pranë, e pritën fëmijën. Ishte vajzë... - foli shoferi për ta zbutur situatën. Burrat panë njëri-tjetrin në sy.

- Po ky çfarë po flet...! - murmuriti Qaniu. Doli nga ana e shoferit dhe i foli:

- Nisu tani. Duam të na e çosh djalin shpejt!

Shoferi nuk u ndje. Te porta e spitalit po i priste doktori dhe dy infermierë. Dy djem të rinj shtatlartë e rrëmbyen barelën dhe u futën te dhoma e urgjencës. Vjollca psherëtiu thellë. Ata të tre iu dukën si tre engjëj, me ato përparëset e bardha borë. Ndjeu siguri. Doktori e vizitoi Dritanin me qetësi. Vjollca, me duar të mbledhura në kraharor, u përgjërua:

“Allah! Më shpëto djalin!”

Shikonte çdo lëvizje të mimikës së doktorit. Përpiqej të kuptonte. “Do jetoj? Pse po vonohet kaq shumë...” Doktori ngriti kokën dhe e pa atë. Ia bëri me shenjë infermierit që i rrinte pranë. Ai e ftoi të ulej dhe i dha një gotë me ujë. Vjollca mori frymë e lehtësuar.

- Kur ka ndodhur kjo, - pyeti doktori.

Vjollca u tremb. U ngrit në këmbë. E pa në sy dhe iu mor goja.

- Doktor, do jetojë im bir? Doktor, unë nuk di gjë, isha në punë...

- Qetësohu! Tani je në spital. Ne do ta shërojmë tët bir. Ulu! Të pyeta, se kur ka ndodhur kjo.

Vjollca, e hutuar, sikur përgjigjja e saj do të vendoste fatin e të birit, i tha:

- Nuk e di, doktor. Mbase nga dreka. Unë nuk isha në shtëpi. Asnjë nuk e pa, - dhe ia plasi të qarit me të madhe. - Unë isha në punë, se ne punojmë ditën, kur natën bie shi...

Jashtë kishin mbërritur burrat, që e kishin bërë me vrap të gjithë rrugën. Dihasnin. Filluan të flisnin të gjithë njëherësh.

- Si është, doktor? Do të shërohet? Do të jetojë?

Doktori u përpoq t'i qetësonte të gjithë.

- Do të qëndrojnë vetëm prindërit. Ju të tjerët do të rriini jashtë.

Burrat panë njëri-tjetrin në sy. Qaniu doli përpara.

- Doktor, babanë s'ë ka. Kjo është e ëma. Për çfarëdo që të kesh nevojë, jemi ne të gjithë. Po të duhen pare, do të t'i japim ne.

- Nuk ka nevojë për pare, ju do të prisni jashtë! - ndërhyri doktori. Burrat dolën jashtë në heshtje.

Pasi bënë formalitetet, të plagosurin e ngritën në krahë dhe e futën brenda sallës. Gjithçka po bëhej aq shpejt, sa që Vjollca s'po kuptonte asgjë. E futën në një derë. Doktori i drejtua asaj.

- Ti do të ulësh aty te stoli, me djalin, do të merremi ne.

Vjollca mori guxim dhe e pyeti:

- Si të quajnë ty, doktor?

- Ervin!

- Ta gëzosh! Të të rrojnë kalamajtë!

- Faleminderit! - Ervini, duke qeshur, u nis drejt sallës së operacionit. Sapo kishte shpallur fejesën me doktoreshë Albanën.

Vjollca e ndoqi pas.

- Në paçi Perëndi, doktor Ervini!

Gjestet, frymëmarrja e saj, shfaqeshin në atë fytyrë gati prej fëmije. Doktori s'po kuptonte asgjë. Ndaloi një hop dhe e pa në sy. Sytë e saj, të çuditshëm. "Sa të mëdhenj! S'kam parë sy të tillë..." Një lot i shndritshëm i rrotullohej në sy duke krijuar një lojë diamantesh me ndriçim ylberi. Ervini u kthye nga ajo dhe i vuri dorën në sup. Ndjeu një dridhje e ngashërim që i buronte nga brenda, me shkullmë. Gjithë qenia e saj po dridhej si vetëtimat e saj në sy.

- Të lutem, qetësohu! Mos ki frikë! - e qetësoi ai dhe u nis për në sallën e operacionit. Vjollca s'po rrinte dot në këmbë. U ul në gjunjë. I ndjeu sikur i kishte të thyer gjunjët. Një